



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 10, datë 06.02.2024

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 190, DATË 22.12.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “MUJO ULQINAKU” PALLATI NR.72, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit” i ndryshuar me Urdhërin nr.222, datë 06.07.2020, Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022, Raportit me nr. 933/1 prot., datë 26.01.2024 të Komisionit të Posaçëm si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave në Aneksin 1, bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 190, datë 22.12.2023, përsa i përket listës së përfituesve për pallatin nr.72, rruga “Mujo Ulqinaku”, në Njësinë Administrative nr.4, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 hartuar nga Komisioni i Posaçëm, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi, si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT, QË DO PËRFITOHET
10	VJOLLCA ÇAKANI, ERJON ÇAKANI	2	1+1
11	NIKOLLA NIKOLLA, LEZE NIKOLLA	3	2+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 07.02.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 94/10 prot.

Durrës, më 15.02.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.10 datë 06.02.2024 “Për miratimin e disa shtesave në aneksin 1, bashkalidhur VKB Nr 190 dt 22.12.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Nr 4, Rruga “Mujo Ulqinaku” Pallati Nr 72, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

